REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I SHQIPËRISË

# PROCEDURA PËR LICENCËN E OPERIMIT TË TRANSPORTUESIT AJROR
PRC.O5 – 1.PRC.01

Në përputhje me: ISO 9001:2015

DHJETOR
2022

© Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë 2022 - Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Hyrje

Ky dokument është pronë e:

**Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë**

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

**Drejtor Ekzekutiv**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE - AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL - TIRANË

## I. MIRATIMI I PROCEDURËS

| | Emri dhe pozicioni | Datë | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| Përgatitur nga: | Kejda Koshaj, Inspektor në SLOSHLF<br>Redi Buçka, Inspektor në SLOSHLF | 8.12.2022<br>9.12.2022 | |
| Pranuar: | Amarilda Nakuçi, Përgjegjës i SLOSHLF | 9.12.2022 | |
| Kontrolluar nga: | Edlira Kraja, Drejtor i DSTMP | 9.12.2022 | |
| Miratuar nga: | Maksim Et'hemaj, Drejtor Ekzekutiv | 15.12.22 | REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL TIRANE |

## II. LISTA E SHPËRNDARJES

| Përdoruesi | Media/Mediumi | Sasia |
|---|---|---|
| Arkivi | Në Letër | 1 |
| | Elektronike | 1 |
| Intranet | Elektronike | 1 |

## III. REGJISTËR I RISHIKIMEVE

| Nr: | Datë: | Natyra e Ndryshimit | Rishikuar nga: |
|---|---|---|---|
| 01 | | Rishikimi i procedurës për licencat e operimit për transportuesit ajror sipas standardave të përcaktuara nga njësia e kontrollit dhe ruajtjes së cilësisë. Përditësimi i procedurës në tërësi në raport me bazën ligjore në fuqi. | Znj.Amarilda Nakuçi<br>Znj. Kejda Koshaj<br>Z. Redi Buçka |
| 02 | | | |
| 03 | | | |
| 04 | | | |

Tabela e Përmbajtjes:


I. MIRATIMI I PROCEDURËS ........................................ 3
II. LISTA E SHPËRNDARJES ........................................ 3
III. REGJISTËR I RISHIKIMEVE ........................................ 3
1. QËLLIMI ........................................ 5
2. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE ........................................ 6
3. STRUKTURA, FUNKSIONET DHE DETYRAT E SLOSHL ........................................ 11
4. PËRGJEGJËSITË ........................................ 8-10
5. PËRSHKRIME TË PROCESEVE TË PUNËS PËR DHËNIEN E LICENCËS SË OPERIMIT ........ 24
6. PROCESET E PUNËS PËR MONITORIMIN E VLEFSHMËRISË SË LICENCËS SË OPERIMIT ........................................ 20-23
7. PROCESET E PUNËS PËR PEZULLIMIN DHE ANULIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT ...23-24
8.BASHKËPUNIMI ME NJËSITË E BRENDSHME TË INSTITUCIONIT ........................................ 24
9.FORMAT ........................................ 24-25
10.REKORDET ........................................ 25

## 1. QËLLIMI

1.1 Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit, pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës, është struktura që ndjek dhe siguron mbarëvajtjen e proceseve të lëshimit, pezullimit dhe revokimit të licencave të operimit të transportuesve ajrorë. Qëllimi i procedurës është që të përcaktojë hapat dhe kriteret për licencimin e transportuesve ajrore civilë të Republikës së Shqipërisë për të kryer transportim të pasagjerëve, mallrave dhe postës.

Përgatitja e informacionit të kësaj procedure është bërë duke pasur parasysh standardet e përcaktuara në Manualin e Cilësisë së AAC- së, miratuar me Vendimin Nr 13, datë 24.06.2021 "Për miratimin e manualit të Cilësisë", rishikimi Nr.02.

*Përkufizimi i termave në kuptim të kësaj procedure:*

| **Termi** | **Përkufizimi** |
|---|---|
| Licencë operimi | Autorizim i dhënë nga autoriteti kompetent licencues një sipërmarrjeje, për të kryer transport ajror të pasagjerëve, të postës dhe ose të ngarkesave, duke e lejuar atë të ofrojë shërbime ajrore siç është parashikuar në licencë operimi. |
| Autoriteti Kompetent Licencues | Autoriteti i Aviacionit Civil që ka të drejtë të japë, refuzojë, të anulojë ose të pezullojë një licencë operimi. |
| Shërbim ajror | Një fluturim ose një seri fluturimesh më qëllim tranportin e pasagjerëve, ngarkesës dhe/ose postës me pagesë dhe/ose me qira. |
| Fluturim lokale (të brendshme) | Fluturim që nuk përfshin transportin e pasagjerëve, postës dhe/ose ngarkesës ndërmjet aeroporteve të ndryshme ose pika të tjera të autorizuara uljeje. |
| Komision | Komisioni i Dhënies së Licencave të Operimit është një strukturë e posaçme administrative që krijohet nga titullari i autoritetit licencues kompetent |
| Transportues ajror | Sipërmarrje me një licencë të vlefshme operimi ose një licencë operimi të vlefshme |
| Transportues ajror i huaj | Transportues ajror me një licencë të vlefshme operimi të dhënë nga një autoritet licencues kompetent i huaj |
| Plan biznesi | Përshkrim i hollësishëm i veprimtarive tregtare të synuara nga transportuesi ajror për periudhën në fjalë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e pritshëm të tregut dhe investimet që do të kryhen, duke përfshirë implikimet financiare dhe ekonomike të |

| | |
|---|---|
| | këtyre veprimtarive. |
| Vendi kryesor i biznesit | Zyra qendrore ose zyra e regjistruar e një transportuesi ajror në Republikën e Shqipërisë, brenda të cilit ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operues, duke përfshirë menaxhim të vazhdueshëm të gatishmërisë për punë të avionëve, të transportuesit ajror shqiptar. |
| Transportues ajror i ZPEA-së | Tranportues ajror me një licencë operimi të vlefshme të lëshuar nga një autoritet kompetent licencues në përputhje me parashikimet e marrëveshjes shumëpalëshe. |
| Transportues ajror shqiptar | Transportues ajror me një licencë operimi të vlefshme të lëshuar nga një autoritet licencues kompetent – AAC. |
| Marrëveshje shumëpalëshe | Marrëveshja shumëpalëshe, shtojcat dhe Protokolli i saj për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, "Për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Evropian", në vijim referuar si marrëveshja shumëpalëshe |
| Fluturimet për qëllime private | Përfshijnë operimet e një avioni me anë të të cilit një person ose sipërmarrje kryen operime jotregtare në trafikun ajror kombëtar ose ndërkombëtar për transport të personave dhe sendeve për përdorim vetjak. |
| Avionë me fuqi ultra i lehtë | Avioni ultra i lehtë, me një peshë maksimale ngritjeje më të ulët se 5700 kg, shtyrja/tërheqja e të cilit në ajër realizohet nga fuqia e një motori. |
| SLOSHLF | Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit. |

***Simbolet e përdorura gjatë përshkrimit të proceseve kanë këtë kuptim:***

⬭ Fillimi/Fundi i procesit/procedurës

▭ Aktivitet

◇ Pikë vlerësimi, vlerësim i një aktiviteti (me përgjigje PO ose JO)

2. Për hapin e parë dhe të fundit do të përdoret forma ovale. Ovalet do të tregojnë hapa konkret që e aktivizojnë ose përmbyllin procesin (p.sh. shprehja e interesit, lëshimi apo refuzimi i certifikatës, zgjedhja e zyrtarit, mbyllja e dosjes) e jo vetëm "Fund" pasi ky hap është i fundit dhe tregohet vizualisht me formë ovale.
3. Vija e veprimit që rikthehet në ndonjërin prej hapave paraprakë është përdorur në anën e djathtë në rastet kur ekziston vetëm një kolonë. Nëse ekzistojnë dy kolona paralelisht, ajo është përdorur edhe në anën e majtë.
4. Në hapat ku ka opsione (kutia romb apo "Decision" është shkruar pranë vijave "PO", "JO" ose diçka tjetër. Rrjedhimisht edhe teksti i kutisë do të jetë në formë pyetjeje.

## 1. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

Në shqyrtimin dhe trajtimin e licencave të operimit për transportuesit ajrorë, SLOSHLF bazohet në rregullatorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë.
Gjatë kryerjes së punës, përsa i takon faktorit ligjor, stafi i SLOSHLF mban gjithmonë në konsideratë që:
1. Çdo procedurë për lëshimin e miratimit për llojin e fluturimit të përmbajë referencën ligjore përkatëse.
2. Në rast të ndryshimeve të dispozitave ligjore dhe rregullatore të zbatojë referencat e ndryshuara

1. Ligji nr. 96/2020 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë"
2. Ligji Nr.53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil"
3. Udhëzimi Nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajore", i ndryshuar që transpozon Rregulloren Evropiane Nr. 1008/2008
4. Marrëveshjet dypalëshe të lidhura në fushën e transportit ajror ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera, kur ato kanë parashikime që lidhen në mënyrë direkte apo indirekte me licensimin.

## 3. STRUKTURA, FUNKSIONET DHE DETYRAT E SLOSHLF

Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit është pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit të Transportit Ajror dhe Infrastrukturës (DZHTAI), sipas strukturës së AAC-së, miratuar me Urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.359, datë 18.12.2020 "Për miratimin e strukturës së AAC-së".

Figura 1. Organigrama e DZHTAI




## 4. PËRGJEGJËSITË

Roli dhe përgjegjësitë e SLOSHLF janë në përmbushje të përshkrimeve të punës të miratuara në Rregulloren e Brendshmë të AAC-së, miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës Nr.03, datë 28/05/2021.

### 4.1 Detyrat kryesore të Përgjegjësit të SLOSHLF

- Koordinon dhe realizon të gjithë procesin për dhënien e lejeve të fluturimit për fluturime të rregullta dhe ato charter.
- Propozon skedulat sezonale, bazuar në kërkesat e operatorëve ajrorë dhe koordinimin me aeroportet përkatëse.
- Mbledh të dhëna statistikore mbi fluturimet e menaxhuara, në bazë mujore, 6 mujore dhe vjetore dhe kryen analiza të të dhënave statistikore.
- Mbikëqyr zbatimin e sloteve të dhëna, respektimin e orareve dhe lejeve të fluturimit akorduar operatorëve ajrorë ne aeroporte dhe analizon të dhëna statistikore të mbajtura për to.
- Propozon për potencialin e mundshëm të kategorizimit të një aeroporti të koordinuar apo fasilituar, bazuar në të dhëna mbi kapacitetin.
- Në rastin e një aplikimi për licencë të operatorit ajror, siguron që të ndiqet procedura e përcaktuar në aktet rregullatore në fuqi dhe është pjesë aktive e procesit të licencimit.
- Siguron verifikimin e vazhdueshmërisë së përputhshmërisë me kushtet e licencimit, gjatë ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ajrorë, në bashkëpunim me Sektorin e Mbikëqyrjes Ekonomike të Ofruesve të Shërbimeve.

- Siguron zbatimin e parashikimeve për shërbimet në tokë, gjatë procesit të autorizimit të një ofruesi të tillë, në bashkëpunim me Sektorin e Mbikëqyrjes Ekonomike të Ofruesve të Shërbimeve.
- Përcakton objektivat dhe planin e veprimtarisë së Sektorit, me qëllim realizimin e misionit të Drejtorisë.
- Planifikon aktivitetet inspektuese dhe i përcjell tek Drejtori i Drejtorisë për miratim.
- Shpërndan punën mes inspektorëve të Sektorit në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren e brendshme të institucionit.
- Qartëson stafin në varësi të tij për objektivat dhe detyrat e secilit, dhe organizon punën me qëllim realizimin në kohë, cilësi dhe sasi të objektivave të miratuara nga Drejtoria.
- Monitoron punën e Sektorit dhe realizon vlerësimet periodike të stafit në varësi për të identifikuar nevojat për përmirësim.
- Përgjigjet për zhvillimin e një sistemi informacioni në kuadër të Sektorit që drejton, në mënyrë që problemet e ndryshme të mund të identifikohen në kohë.
- Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës në strukturën që drejton dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
- Formulon sugjerime për ndryshime apo përmirësime të akteve apo projektakteve dhe ia paraqet ato Drejtorit të Drejtorisë.
- Formulon raporte periodike ose mbi bazë kërkese për Drejtorin e Drejtorisë në lidhje me veprimtarinë e Sektorit dhe rezultatet e saj në përmbushje të planit vjetor.
- Jep informacione për çështje të ndryshme që mbulon Sektori mbi bazë kërkese.
- Mbledh dhe analizon të dhëna.
- Siguron përgatitjen e manualeve për përdorim të Sektorit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.
- Bashkëpunon me Ministrinë e Mbrojtjes për lejet e fluturimit të avionëve ushtarakë dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për lejet e fluturimit të avionëve Shtetërorë dhe Diplomatikë.
- Bashkëpunon me strukturat përkatëse si brenda dhe jashtë institucionit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, sipas kërkesave dhe nevojave të Sektorit.
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Standardizimit Teknik dhe Monitorimit të Përputhshmërisë për hartimin e procedurave të realizimit të proceseve të këtij Sektori.

### 4.2 Detyrat kryesore të Inspektorit të SLOSHLF

- Mban të gjithë dokumentacionin e licencimit dhe kryen regjistrimet e nevojshme sipas një procedure të paracaktuar
- Eshtë pjesë e procesit të licencimit, duke garantuar zbatimin e procedurës me përpikmëri sipas kërkesave rregullatore.
- Ndjek procesin e amendimit të një licence.
- Përgatit praktikën dhe komunikimet me aplikuesit gjatë procesit të licencimit dhe pas tij.

- Kryen inspektime për të monitoruar përmbushjen e vazhdueshme të kushteve për mbajtjen e licencës së operimit të operatorit ajror, në bashkëpunim me Sektorin e Mbikëqyrjes Ekonomike të Ofruesve të Shërbimeve.
- Përditësohet me zhvillimet e vazhdueshme në drejtim të legjislacionit të Komunitetit për licencimin dhe propozon ndryshime të mundshme në legjislacionin kombëtar.
- Merr masa që operatorët e licencuar të përmbushin detyrimet e dërgimit të të dhënave financiare periodike, siç përcaktohet në Kodin Ajror të RSH dhe Urdhërit të Ministrit për Licencën e Operatorit Ajror.
- Harton materiale rregullatore, udhëzime dhe procedura në lidhje me dhënien e lejeve të fluturimit, për përafrimin e tyre me rregulloret e KE.
- Qëndron në gatishmëri në kohë reale për çdo ngjarje dhe ndryshim lidhur me lejet e fluturimit.
- Garanton përshtatshmërinë e AAC-së ndaj detyrimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me dhënien e lejeve të fluturimit.
- Vepron për dhënien e lejeve të fluturimit për fluturimet e rregullta dhe jo të rregullta si: charter, taksi, emergjence, spitalore si dhe të shërbimeve të veçanta dhe emergjente sipas ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve në fuqi, si dhe parashikimeve të përfshira në AIP-in e Republikës së Shqipërisë
- Shpërndan dhe përgjigjet për shpërndarjen e materialeve të rinovuara në lidhje me dhënien e lejeve të fluturimeve.
- Së bashku me Përgjegjësin e Sektorit përcakton objektivat dhe planin e veprimtarisë së Sektorit, me qëllim realizimin e misionit të Drejtorisë.
- Realizon detyra teknike në lidhje me licencat e operimit dhe lejet e fluturimit.
- Raporton mbi të dhënat në lidhje me licencat e operimit dhe lejet e fluturimit.
- Informon Përgjegjësin e Sektorit, periodikisht ose mbi bazë kërkese, për mbarëvajtjen e aktivitetit që kryen dhe propozon masa për përmirësime kur e gjykon të nevojshme.
- Në varësi të rezultateve të inspektimit dhe monitorimit të vazhdueshëm, në bashkëpunim me Sektorin e Mbikëqyrjes Ekonomike të Ofruesve të Shërbimeve propozon për masa të mundshme ndaj operatorit përkatës.
- Bashkëpunon me Ministrinë e Mbrojtjes për lejet e fluturimit të avionëve ushtarakë dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për lejet e fluturimit të avionëve Shtetërorë dhe Diplomatikë.
- Transmeton tek Albcontrol të gjitha llojet e ndryshimeve në skedul të linjave ajrore që operojnë për dhe nga Aeroporti ''Nënë Tereza'', në bashkëpunim me stafin përkatës të TIA-s.
- Bashkëpunon me njësinë e financës për mbarëvajtjen e ekzekutimit të pagesave lidhur me shërbimin e lejeve të fluturimit.

# 5. PËRSHKRIME TË PROCESEVE TË PUNËS PËR DHËNIEN E LICENCËS SË OPERIMIT

5.1 Komisioni i Dhënies së Licencave të Operimit

1. Komisioni i Dhënies së Licencave të Operimit është strukturë ad hoc e ngritur me udhër të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil,
2. Ky Komision ka autoritetin për shqyrtimin, miratimin, refuzimin, anulimin ose pezullimin e një licencë operimi.
3. Në hartimin e Urdhrit përcaktohet përbërja (kryetar, nënkryetar, sekretar dhe anëtarë), kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë sipas kësaj përbërje, si dhe mënyra e informimit/raportimit tek Drejtori Ekzekutiv i AAC. Duke qënë se Komisioni do të shqyrtojë çështje financiare, ligjore dhe teknike deri diku, mbahet në vëmendje që në përbërje të tij të ketë ekonomistë, juristë, staf teknik etj.
4. Detyrën e sekretarisë së Komisionit e kryen sektori përgjegjës për licencat e operimit të transportuesve ajrorë në AAC.
5. Komisioni kryen funksionet në përputhje me udhëzimin për rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore respektive.

## 5.2 Kushtet për dhënien e licencës së operimit

Për të kryer transport ajror me karakter tregtar të pasagjerëve, të postës dhe/ose të ngarkesave, çdo sipërmarrës nevojitet që të pajiset me licencë operimi.

Me qëllim marrjen e licencës së operimit nga AAC, si organi kompetent licencues, sipërmarrja duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) vendi kryesor i veprimtarisë është Republika e Shqipërisë ose, nëse vendi kryesor i veprimtarisë nuk është Republika e Shqipërisë, zyra ku është regjistruar biznesi të jetë në Republikën e Shqipërisë;
b) zotëron një certifikatë të vlefshme të operatorit ajror, të lëshuar nga AAC, i cili është përgjegjës për dhënien, refuzimin, anulimin ose pezullimin e licencës së operimit të transportuesit ajror;
c) ka një ose më shumë avionë në dispozicion përmes pronësisë ose marrëveshjes së qirasë së avionit pa personelin dhe sigurimin (qira e thatë- dry lease);
d) objekti i veprimtarisë është vetëm transporti ajror ose transporti ajror i kombinuar me çdo operim tjetër tregtar të avionëve apo tranporti ajror i kombinuar me riparim dhe mirëmbajtje avionësh;

e) struktura organizative e saj, mundëson autoritetin licencues kompetent të zbatojë dispozitat e këtij udhëzimi;
f) zotërohet dhe vazhdon të zotërohet drejtpërdrejt ose nëpërmjet shumicës së pronësisë nga Republika e Shqipërisë dhe/ose shtetas të saj, apo një ose më shumë shtete të ZPEA-së dhe/ose shtetas të ZPEA-së, si dhe është gjatë të gjithë kohës e kontrolluar efektivisht nga Republika e Shqipërisë dhe/ose nga shtetas shqiptarë, ose një a më shumë shtete të ZPEA-së dhe/ose shtetas të tyre, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;
g) plotëson kushtet financiare të cituara në pikën 5.2.1 më poshtë;
h) përputhet me kërkesat për sigurimin, të përcaktuara në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
i) përputhet me dispozitat për reputacionin e mirë/ provon se personat që do e drejtojnë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme shoqërinë kanë reputacion të mirë, i cili nënkupton faktin që nuk janë deklaruar zyrtarisht të falimentuar.

### 5.2.1 Kushtet financiare për dhënien e një licence operimi

1. Kur një sipërmarrës aplikon për herë të parë për licencë operimi, AAC vlerëson me kujdes nëse ky sipërmarrës:

a) përmbush në çdo kohë detyrimet e tij aktuale dhe potenciale të ngritura sipas supozimeve reale, për një periudhë prej 24 muajsh nga fillimi i operimeve dhe
b) ka aftësi paguese për shpenzimet e tij fikse dhe operative që lindin nga operimet sipas planit të tij të biznesit dhe të ngritura sipas supozimeve reale, për një periudhë prej 3 muajsh nga fillimi i operacioneve, pa marrë parasysh ndonjë të ardhur nga operimet, në mënyrë që të vlerësohen këto pika nga ana e AAC-së, sipërmarrësi/aplikanti duhet të paraqesë:

1. Plan biznesi për të paktën 3 vitet e operimit. Ky plan duhet të përcaktojë hollësisht lidhjet financiare të aplikuesit me çdo veprimtari tjetër tregtare në të cilën aplikanti është i angazhuar ose direkt, ose nëpërmjet sipërmarrjeve të lidhura me të.
2. Informacioni që duhet të jepet nga një aplikues për herë të parë nga pikëpamja e përshtatshmërisë financiare
   *2.1 Llogaritë e brendshme më të fundit të menaxhimit dhe, nëse disponohen, llogaritë e audituara për vitin e mëparshëm financiar.*
   *2.2 Një bilanc të planifikuar, përfshirë llogaritë e fitimit dhe humbjes për tri vitet e mëparshme.*
   *2.3 Bazën për shpenzimet e planifikuara dhe shifrat e të ardhurave për zëra të tillë, si lënda djegëse, çmimet dhe tarifat, pagat, mirëmbajtja, zhvlerësimi, luhatjet e kursit të këmbimit, tatimet e aeroportit, tatimet e lundrimit ajror, shpenzimet bazë të tregtimit, sigurimi etj. Parashikimi i të ardhurave/trafikut.*
   *2.4 Detaje të shpenzimeve të ndezjes/nisjes që kanë ndodhur në periudhën nga paraqitja e një aplikimi për fillimin e operimeve dhe një shpjegim se si propozohet të financohen këto shpenzime.*
   *2.5 Detaje të burimeve financiare ekzistuese dhe të planifikuara.*

*2.6 Detaje të aksionerëve, duke përfshirë shtetësinë dhe tipin e aksioneve që zotërohen dhe nenet e shoqërisë. Nëse është pjesë e një grupimi sipërmarrjesh, informacion për marrëdhënien ndërmjet tyre.*
*2.7 Deklarata të planifikuara të qarkullimit të parave dhe planet e likuiditetit për tri vitet e para të operimit.*
*2.8 Detajet e financimit të blerjes/qiramarrjes së avionëve, duke përfshirë në rastin e qiramarrjes, afatet dhe kushtet e kontratës.*

### 5.3 Rastet përjashtimorë

Në procesin e vlerësimit të pajisjes apo jo me licencë operimi mbahet parasysh fakti që:

1. Përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me licencë operimi kategoritë e shërbimeve ajrore si më poshtë:

a) shërbimet ajrore të kryera nga avionë pa ndezje motorike dhe/ose avionë me fuqi ultra të lehtë;
b) fluturimet lokale.

2. Asnjë sipërmarrje e themeluar në Republikën e Shqipërisë nuk lejohet të transportojë në mënyrë ajrore pasagjerë, postë dhe/ose ngarkesë për pagesë dhe/ose me qira ( për qëllime fitimi) nëse nuk i është dhënë një licencë operimi e rregullt.

3. Duke qënë se, për përdorim të shërbimit ajror privat nuk lëshohet AOC- Certifikatë e Operatorit Ajror, atëherë nuk lëshohet as AOL – Licencë operimi për transportuesin ajror. Kjo, sepse AOL lëshohet gjithmonë bazuar në specifikimet e AOC.

4. Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar sipas pikave 5.2.1 nuk zbatohen për sipërmarrje që aplikon për një licencë operimi, me qëllim mbulimin e operimeve me avion me më pak se 10 ton masë uljeje maksimumi (MTOM) dhe/ose më pak se 20 vende. Sipërmarrje të tilla duhet të tregojnë se kapitali i tyre neto është të paktën 100 000 euro ose të sigurojnë, kur të kërkohet nga autoriteti licencues kompetent, i gjithë informacioni për qëllime vlerësimi të përmendur në pikën 5.2.1, e veçanërisht të dhënat e përmendura në paragrafin 5.2.1, pika 2.

5. Nëse sipërmarrja kërkon të kryejë shërbime ajrore të programuara ose xhiroja e saj i kalon 3 milionë euro në vit, atëherë dokumentacioni financiar i përcaktuar në pikën 5.2.1 do të kërkohet dhe shqyrtohet nga AAC.

### 5.4 Avionët e marrë me qira të thatë dhe të njomë

Në vlerësimin e pikës 5.2, gërma (c) mbahet parasysh informacioni i mëposhtëm:

1.Një transportues ajror i Republikës së Shqipërisë mund të ketë një ose më shumë avionë në dispozicion të tij nga marëveshja e qirasë së avionit me ose pa personelin dhe sigurimin (dry ose wet lease). Ata mund të përdorin avionë të marrë me wet lease të regjistruar brenda ZPEA, me kusht që të mos cënojë sigurinë ajrore. Çështja e sigurisë trajtohet me njësitë përkatëse në AAC.
2. AAC duhet të japë paraprakisht miratimin nëse:
2.1 transportuesi ajror provon se përmbush të gjitha standardet e sigurisë, të barazvlefshme me ato të përcaktuara në legjislacionin shqiptar; dhe
2.2 plotësohet njëri nga kushtet
2.2.1 transportuesi ajror justifikon një dhënie me qira në kushte të jashtëzakonshme, për të cilin mund të jepet miratim për një periudhë deri në 7 muaj, e cila mund të rinovohet edhe për një periudhë shtesë 7 mujore.
2.2.2 transportuesi ajror demonstron se dhënia me qira është e nevojshme për të plotësuar nevojat e kapacitetit sezonal dhe që nuk mund të plotësohen në mënyrë të arsyeshme nga avionë të regjistruar brenda RSH apo ZPEA-së sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, rast në të cilin miratimi mund të rinovohet
2.2.3 tranportuesi ajror demonstron se dhënia me qira është e nevojshme për të kapërcyer vështirësitë e operimit dhe nuk është e mundur ose e arsyeshme të jepet me qira ndonjë avion i regjistruar brenda RSH, apo ZPEA-së sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, rast në të cilin miratimi do të jetë më kohëzgjatje të kufizuar, për aq sa është e nevojshme të kapërcehen vështirësitë.

## 5.5 Hapat e procesit të punës për dhënien e licencës së operimit

1. Sipërmarrësi/Aplikanti përcjell kërkesën në formë shkresore pranë AAC për pajisje me licencë operimi sipas Formës 05-1.FPRC.01.FRM.01 të kësaj Procedure, duke u kujdesur të sjellë bashkëlidhur gjithë dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:
   *1.1 Dokument nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nëpërmjet të cilit vërtetohet që subjekti/sipërmarrësi nuk është në proces likuidimi ose falimentimi.*
   *1.2 Dokument që vërteton së kapitalet/asetet e sipërmarrjes nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit.*
   *1.3 Kopje e noterizuar e aktit të themelimit.*
   *1.4 Kopje e noterizuar e statutit dhe kopje e noterizuar e vendimeve të asamblesë së aksionerëve/ortakëve të marra për ndryshime të mundshme në statut, nëse ka të tilla.*
   *1.5 Dokument nga QKB që vërteton përbërjen e sipërmarrjes (ortakët/aksionerët).*
   *1.6 Për përfaqësuesit ligjorë dhe anëtarët e organit administrativ kërkohen certifikatat personale, vërtetim banimi si dhe certifikatë të gjëndjes gjyqësore.*

2. Shqyrtohet paraprakisht nëse përbën rast për t'u pajisur me licencë operimi, duke iu referuar rasteve përjashtimorë dhe çdo rasti tjetër që mund të përbëjë përjashtim ligjor.
3. Shqyrtohet dokumentacioni provues në lidhje me kërkesën dhe inicimin e procesit për lëshimin e Certifikatës së Operatorit Ajror (COA).
4. Nëse përbën rast për t'u pajisur me licencë operimi, përgatitet Urdhri dhe ngrihet Komisioni për Dhënien e Licencës së Operimit (KDHLO).
5. Shqyrtimi nga KDHLO i gjithë dokumentacionit të përcaktuar në pikën 5.2 duke përfshirë nga Form 05-1.FPRC.01.FRM.01 deri tek Forma 05-1.FPRC.01.FRM.08, në Aneks, të cilat përmbajnë informacion financiar të sipërmarrësit, në mënyrë që të kryhet analiza përkatëse dhe të realizohet konstatimi i përmbushjes së kritereve financiare. Specifikisht, këto forma kanë të bëjnë me:
   5.1 Forma 05-1.FPRC.01.FRM.02 i referohet planit të biznesit
   5.2 Forma 05-1.FPRC.01.FRM.03 përmbledh informacionin për të ardhurat e parashikuara mbi baza mujore për vitin e parë të aktivitetit.
   5.3 Forma 05-1.FPRC.01.FRM.04 jep informacion mbi performancën ekonomike të parashikuar për 3 vitet e para të aktivitetit.
   5.4 Forma 05-1.FPRC.01.FRM.05 jep pasqyrën e kapitalit të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit për 3 vitet e para (gjendja e kapitalit).
   5.5 Form 05-1.FPRC.01.FRM.06 pasqyron flukset e parashikuara të parasë për vitin e parë të aktivitetit, për çdo zë kryesor të arkëtimeve dhe pagesave sipas tipologjisë së shërbimit të arkëtuar/paguar.
   5.6 Forma 05-1.FPRC.01.FRM.07 jep parashikimet per indikatorët operativë.
   5.7 Forma 05-1.FPRC.01.FRM.08 përfshin skedën e monitorimit 6-mujor.
6. Plani i biznesit duhet të paraqesë periudhën 3 vjeçare të planifikimit të operimeve dhe duhet të përmbajë informacionin si më poshtë:
   *6.1 Përmbledhjen ekzekutiv.*
   *6.2 Përmbledhjen e kompanis.*
   *6.3 Analizën SWOT*
   *6.4 Shërbimet*
   *6.5 Analizën e tregut*
   *6.6 Strategjinë zbatuese*
   *6.7 Përmbledhje të menaxhimit*
   *6.8 Vlerësimi i rrezikut të biznesit dhe atij financiar*
   *6.9 Parashikimet financiare*
7. Verifikimi i përshtatshmërisë ekonomike – financiare kryhet nëpërmjet analizës që ka të bëjë me:
   *7.1 Besueshmërinë e parashikimeve bazë si psh trafiku i parashikuar, të ardhurat etj*
   *7.2 Koherencën e planeve si në aspektin operacional dhe atë ekonomiko-financiar. Në aspektin operacional përfshihen, por nuk kufizohen në, disponibiliteti i avionëve, personelit të duhur të fluturimit dhe në tokë, sipas operimeve të deklaruara, sloteve etj.*

*7.3 Saktësinë e rezultateve të parashikuara të të ardhurave neto nga shitjet dhe të qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve financiare për një periudhë 36 mujore nga fillimi i operimeve.*

*7.4 Disponibilitetin e burimeve financiare të mjaftueshme për të përmbushur kostot fikse dhe operative, parashikuar për 3 muajt e parë të aktivitetit, pa marrë parasysh të hyrat që derivojnë nga operimet e fluturimit*

*7.5 Përpunimin e të dhënave kryesore ekonomike pasurore të të dhënave konkrete dhe analizës benchmark (çmimeve të referencës).*

8. Shqyrtimi i kriterit të reputacionit të mirë nëpërmjet vlerësimit të dokumentave që provojnë që sipërmarrësi nuk ka patur faliment. Ky dokumentacion nevojitet që të jetë i lëshuar jo më shumë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes.
9. Për çdo takim të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacioneve do të mbahen procesverbale.
10. Nëse ka informacione që mungojnë, AAC komunikon me sipërmarrësin aplikant për ta plotësuar atë.
11. Nëse e gjykon të nevojshme, AAC do të zhvillojë senca dëgjimore me sipërmarrësin gjatë fazës së shqyrtimit për dhënien e licencës së operimit.
12. AAC do të marrë një vendim për një aplikim jo më vonë se 3 (tre) muaj nga momenti që është paraqitur i gjithë informacioni i nevojshëm, duke marrë parasysh të gjitha provat e disponueshme. Për procesin e ndjekjes së vlerësimit dhe realizimit të lëshimit ose jo të licencës së operimit mbahet i informuar Ministri.
13. Nëse merr vendim për refuzim të kërkesës për pajisje me licencë operimi, i duhet argumentuar arsyeja e refuzimit sipërmarrësit. Brenda periudhës 10 ditore, nga marrja e komunikimit, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë me shkrim observacionet e tij, vërtetuar me dokumenta shkresorë origjinalë apo të noterizuara. Në rast të mungesës së observacioneve nga ana e kërkuesit, kërkesa për Licencë Operimi refuzohet.
14. Vendimi për pajisjen me licencë operimi i njoftohet aplikantit dhe i dërgohet licenca sipas Formës 05-1.FPRC.01.FRM.09 në Aneksin 1, pasi të ketë dalë paraprakisht Certifikata e Operatorit Ajror. Licenca nënshkruhet nga Drejtori Ekzekutiv i AAC-së. Vendimi përcillet me shkresë zyrtare sipërmarrësit, nëpërmjet së cilës bëhet komunikimi mbi vendimin e dhënies së licencës së operimit, ku nënvizohen edhe avionët me të cilët shoqëria ajrore autorizohet të kryejë aktivitetin. Bazuar në udhëzimin për caktimin e tarifave të shërbimeve në aviacionin civil kryhet pagesa për licencën e operimit. Modeli i licencës së operimit është i njëjtë, si për tipin A dhe për tipin B, duke patur kujdes të ndryshohen specifikimet (<20 vende), në faqen e dytë të tij.
15. Informacioni mbi dhënien e licencës së operimit i përcillet gjithashtu enteve aeroportuale, njësive të brendshme të AAC-së të cilat janë të interesuara, si dhe palëve të tjera të treta sipas vendimarrjes së Drejtorit Ekzekutiv.
16. Vendimi për dhënien e licencës së operimit publikohet në faqen zyrtare të AAC-së.

**Skema 1. Procesi i punës nga kërkesa e transportuesit ajror deri në marrjen e vendimit për AOL**

| | Autori<br>Sektori/ Drejtoria përkatëse | DZHTAI | SLOSHLF | Drejtori Ekzekutiv | Protokolli dhe publikimet zyrtare | Përshkrimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | | | Kërkesa për aplikim | | | Transportuesi ajror sjell kërkesën për pajisje me licencë operimi |
| 2. | | | Rast për AOL? | | | Shqyrtohet nëse aplikimi përbën rast për t'u pajisur me licencë operimi sipas rasteve përjashtimore dhe kritereve |
| 3. | | | Vlerësimi AOC | | | Verifikohet nëse ka inicuar procesi i shqyrtimin dhe lëshimin e AOC-së |
| 4. | | | Ngritja e Komisionit për Dhënien e Licencave të Operimit | | | Me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv ngrihet Komisioni, i cili shqyrton dhënien, pezullimin, revokimin e anulimin e AOL dhe përbëhet nga kyetari e anëtarët. |
| 5. | | Shqyrtimi i dokumentacionit | | Plani i biznesit<br>Analiza financiare<br>Reputacioni i mirë | | Komisioni merr në shqyrtim të gjithë dokumentacionin sipas formave |
| 6. | | Procesverbal i Komisionit | | | | Komisioni për çdo takim mban procesverbal. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| 7. | Plotësim dokumentacioni/Seanca dëgjimore | Në rast të identifikimit të dokumentacionit mungues, i kërkohet transportuesit ajror të plotësojë dokumentacionin. Sipas nevojave të AAC zhvillohen seanca dëgjimore. |
| 8. | Miratohet kërkesa? | Merret vendim, jo më larg se 3 muaj nga momenti i aplikimit, mbi provat e disponueshme. Mbahet i informuar Ministri për procesin e ndjekjes së vlerësimti dhe realizimit të lëshimit ose jo të AOL |
| 9. | JO: Refuzohet kërkesa<br>PO: Miratohet kërkesa | Nëse kërkesa refuzohet i përcillet vendim i argumentuar, për të cilin priten observacionet, nga transportuesi ajror, brenda 10 ditëve. |
| 10. | Vendimi/Licenca e Operimit | Vendimi i dërgohet aplikantit së bashku me AOL. Gjithashtu i përcillet njësive respektive të AAC-së dhe palëve të treta të interesuara |

| | | |
|---|---|---|
| 11. | Publikimi i Licencës së Operimit | Vendimi për dhënien e licencës së operimit publikohet në faqen zyrtare të AAC-së. |

## 6. PROCESET E PUNËS PËR MONITORIMIN DHE VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË OPERIMIT

6.1 Autoriteti i Aviacionit Civil ka detyrimin të monitorojë operatorin ajror të cilit i ka lëshuar një licencë operimi në rastet e mëposhtme:

a) Dy vjet pasi është dhënë një licencë e re operimi
b) Kur dyshohet një problem i mundshëm, ose
c) Me kërkesë të çdo institucioni tjetër

Kërkesa për monitorim i dërgohet në formë shkresore transportuesit ajror.

6.2 Licenca e operimit do të paraqitet përsëri për miratim nëse operatori ajror i RSH:

a) Nuk ka filluar operimet brenda gjashtë muajve nga dhënia e licencës së operimit
b) Ka ndërprerë operimet e tij për më shumë se gjashtë muaj; ose
c) Kur është licencuar sipas paragrafit 5.3, pika 4 dhe synon të angazhohet në operime me avion mbi kufirin minimal të specifikuar në këtë pikë, ose nëse nuk plotëson më kushtet financiare të vendosura në të.

6.3 Duke qënë se faktori financiar është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e operimeve dhe licencës së operimit, nevojitet që të realizohet mbikëqyrja ekonomike e tranportuesit ajror. Për këtë ky i fundit duhet t'i vërë në dispozicion AAC llogaritë e tij të audituara jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas ditës së fundit të vitit financiar përkatës, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në një akt tjetër ligjor.

6.4 Gjatë 2 (dy) viteve të para të operimeve të një transportuesi ajror të RSH-së , të cilit i është lëshuar një licencë operimi nga autoriteti kompetent licencues, të dhënat e mëposhtme të përditësuara i vihen në dispozicion nga transportuesi ajror, me kërkesë të këtij autoriteti

**Informacioni që duhet dhënë për vlerësimin e përshtashmërisë financiare të vazhdueshme të mbajtësve ekzistues të licencës, paraqitet si më poshtë:**

*6.4.1 Llogaritë e audituara jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e fundit financiar përkatës, vetëm nëse parashikohet ndryshe në ligjin kombëtar, nëse është e nevojshme, bilanci i brendshëm më i fundit i menaxhimit.*

*6.4.2 Një bilanc i planifikuar duke përfshirë llogaritë e fitimit dhe humbjes për vitin e ardhshëm.*

*6.4.3 Shpenzime të kaluara dhe të planifikuara dhe shifra të ardhurash për zëra të tillë, si lënda djegëse, çmimet dhe tarifat, pagat, mirëmbajtja, zhvlerësimi, luhatjet e kursit të këmbimit, tatimet e aeroportit, tatimet e lundimit ajror, shpenzimet bazë të tregtimit, sigurimi etj. Parashikimi i të ardhurave/trafikut.*

*6.4.4 Deklarata e qarkullimit të likuiditetit dhe planet e likuiditetit për vitin pasues.*

6.5 Nëse autoriteti licencues kompetent çmon se ndryshimet në kriteret për dhënien e një licence operimi kanë një lidhje të rëndësishme me financat e tranportuesit ajror të RSH-së, ai do të kërkojë:

6.5.1 paraqitjen e një plani biznesi të rishikuar që përmban ndryshimet përkatëse dhe që mbulon të paktën 12 muaj nga data e implementimi të tij

6.5.2 Informacionin si më poshtë që duhet të jepet për vlerësimin e përshtatshmërisë financiare të vazhdueshme të mbajtësve të licencës ekzistuese që planifikojnë një ndryshim në strukturën ose aktivitetin e tyre me një lidhje të rëndësishme me financat e tyre

*6.5.2.1 Nëse nevojitet, bilanci i brendshëm më i fundit i menaxhimit dhe llogaritë me audit për vitin e kaluar financiar*

*6.5.2.2 Detaje të sakta të të gjitha ndryshimeve të propozuara p.sh ndryshime të tipit të shërbimit, blerja e sipërmarrjes ose shkrirja e propozuar, modifikime në kapitalin aksionar, ndryshime në aksionarë etj.*

*6.5.2.3 Një bilanc i planifikuar, me një llogari fitimi dhe humbjeje për vitin aktual financiar, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e propozuara në strukturë ose aktivitete me një lidhje të rëndësishme me financat e tyre.*

*6.5.2.4 Shpenzime të kaluara dhe të planifikuara dhe shifra të ardhurash për zëra të tilla, si lënda djegëse, çmimet dhe tarifat, pagat, mirëmbajtja, zhvlerësimi, luhatjet e kursit të këmbimit, tatimet e aeroportit, tatimet e lundrimit ajror, shpenzimet bazë të tregtimit, sigurimi etj. Parashikimi i të ardhurave/trafikut.*

*6.5.2.5 Deklarata të planifikuara të qarkullimit të parave dhe planet e likuiditetit për vitin e ardhshëm, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e propozuara në strukturë ose aktivitete me një lidhje të rëndësishme me financat e tyre.*

*6.5.2.6 Detaje të financimit të blerjes/qiramarrjes së avionëve, duke përfshirë në rastin e qiramarrjes, afatet dhe kushtet e kontratës.*

*6.5.2.7 Informacionin financiar shpjeguar në pikën 6.3 dhe 6.4*

6.6 Një transportues ajror i RSH-së do të njoftojë autoritetin licencues kompetent:

6.6.1. Për çdo planifikim në lidhje me kryerjen e një shërbimi të ri ajror në një kontinent ose rajon të botës që nuk është kryer më parë, ose për çdo ndryshim tjetër thelbësor në gamën e

aktiviteteve të tij, duke përfshirë, por jo kufizuar në, ndryshime në tipin ose numrin e avionëve të përdorur;

6.6.2 Paraprakisht për çdo shkrirje apo blerje të synuar.

6.6.3 Brenda 14 ditëve për çdo ndryshim në pronësi të çdo aksioni që përfaqëson 10% ose më shumë të aksioneve të përgjithshme të transportuesit ajror.

6.6.4 Në rastet e modifikimeve të operimeve dhe aktiviteteve që janë thelbësore si tipologjia e shërbimeve, blerje ose shkrirje, ndryshim i aksionerëve e të kapitalit aksioner, AAC i kërkon transportuesit:

*6.6.4.1 Llogarinë më të fundit të aktivitetit të brendshëm dhe bilancit të certifikuar të vitit paraardhës financiar;*

*6.6.4.2 Informacione të sakta të detajuara mbi të gjitha ndryshimet e parashikuara;*

*6.6.4.3 Bilanc programues, i cili të përmbajë llogarinë e fitimeve dhe humbjeve për vitin financiar në vazhdim, përfshirë të gjitha ndryshimet e programuara të strukturës apo aktivitetit që sjellin ndryshime të rëndësishme financiare;*

*6.6.4.4 Të dhëna që kanë të bëjnë me hyrjet dhe daljet e shkuara dhe të ardhshme për fluturimet, si lënda djegëse, tarifat, pagat, mirëmbajtja, amortizimi, luhatja e kursit të këmbimit, shpenzimet aeroportuale, siguracione, parashikime të trafikut etj.*

*6.6.4.5 Relacione mbi lëvizjet e arkës dhe plane të likuiditetit për vitin e ardhshëm, përfshirë të gjitha ndryshimet e parashkuara të strukturës ose të aktivitetit, që kanë impakt të konsiderueshëm financiar;*

*6.6.4.6 Informacione të detajuara mbi financimin e blerjes apo marrjes me qera të avionëve duke përfshirë edhe kushtet dhe afatet e kontratës.*

6.7 AAC do të marrë vendim për planin e rishikuar të biznesit, nëse transportuesi ajror i RSH-së mund të plotësojë detyrimet potenciale dhe ekzistuese gjatë asaj periudhe prej 12 muajsh. Një vendim i tillë do të merret nga AAC jo më vonë se 3 (tre) muaj pasi t'i jetë paraqitur i gjithë informacioni i nevojshëm.

6.8 AAC do të vendosë në lidhje me tranportuesit ajrorë të RSH-së të licencuar nga vetë ai, nëse do të vendosë që licenca e operimit duhet të paraqitet përsëri për miratim, në rast të ndryshimit të një apo më shumë elementëve që cënojnë statusin ligjor të tij dhe në veçanti në rastin e një shkrirjeje ose blerje të aksioneve.

6.9 Në procesin e monitorimit dhe vlefshmërisë së licencës së operimit, nuk do të merren në shqyrtim tranportues ajrorë që përdorin avionë më pak se 10 ton MTOM dhe/ose më pak se 20 vende. Gjithsesi këta transportues duhet të jenë të aftë të demonstrojnë në çdo kohë se kapitali i tyre neto është të paktën 100 000 euro ose të sigurojnë, kur kërkohet nga AAC, informacionin përkatës për qëllimet e vlerësimit të performancës financiare të transportuesit ajror kur ka tregues të qartë se ekzistojnë probleme financiare.

6.10 AAC mund të zbatojë pikat nga 6.3 e deri në 6.9 për transportuesit ajrorë të RSH-së të licencuar nga ai, të cilët kryejnë shërbime ajrore të programuara ose xhiroja financiare e tyre e kalon 3 milionë euro në vit.

## 7 PROCESET E PUNËS PËR PEZULLIMIN DHE ANULIMIN E NJË LICENCE OPERIMI

7.1 AAC mund të vlerësojë në çdo kohë performancën financiare të tranportuesit ajror të RSH-së që ka licencuar. Ky vlerësim shërben për të marrë vendim për pezullimin ose anulimin e licencës së operimit, nëse nuk është më i bindur që tranportuesi ajror mundet të përmbushë detyrimet e tij potenciale dhe aktuale për një periudhë prej 12 muajsh në vijim. Megjithatë, në pritje të organizimit financiar, AAC mund të lëshojë një licencë të përkohshme me afat më pak se 12 muaj sipas Formës 05-1.FPRC.01.FRM.10 në Aneksin 1, me kushtin që siguria të mos rrezikohet dhe të ekzistojë një perspektivë reale për një përmirësim të kënaqshëm financiar brenda kësaj periudhe kohore. Kjo licencë e përkohshme pasqyron, kur duhet, çdo ndryshim në AOC.

7.2 Kur ka tregues të qartë se ekzistojnë probleme financiare ose janë hapur procese procedurale të lidhura me paaftësinë paguese ose procese të ngjashme kundrejt një transportuesi ajror të RSH-së të licencuar, AAC do të kryejë pa vonesë një vlerësim të hollësishëm të situatës financiare dhe në bazë të rezultateve të tij, do të rishikojë statusin e licencës së operimit brenda 3 (tre) muajve.

7.3 Kur llogaritë e audituara, të përmendura në pikat 6.3 deri në 6.9, nuk janë paraqitur brenda afatit të parashikuar, AAC ka të drejtë t'i kërkojë tranportuesit ajror të RSH-së, paraqitjen e llogarive të audituara pa vonesa të tepruara. Nëse llogaritë e audituara nuk paraqiten brenda një muaji, licenca e operimit mund të anulohet ose pezullohet.

7.4 Licenca e operimit anulohet ose pezullohet edhe në rastin kur transportuesi ajror i RSH-së i jep AAC informacion të rremë, me dashje ose nga pakujdesia, për një çështje të rëndësishme.

7.5 Gjithashtu, nëse AOC pezullohet ose anulohet, AAC pezullon ose anulon menjëherë edhe licencën e operimit të transportuesit ajror.

7.8 Edhe mos plotësimi më i kërkesave për reputacion të mirë, përbën arsye për pezullim apo anulim të licencës së operimit të transportuesit ajror të RSH-së.

7.9 AAC përpara se të vendosë pezullimin ose anulimin e licencës së operimit të tranportuesi ajror të RSH-së, duhet të garantojë të drejtën e transportuesit për t'u dëgjuar. Ky rregull vlen edhe për rastet e ndjekjes së një procedure urgjente.

7.10 Për të gjithë procedurën për anulimin apo pezullimin e licencës së operimit, mbahet në dijeni Ministri.

7.11 Vendimet për pezullimin apo anulimin e licencave të operimit publikohen në faqen zyrtare të AAC-së.

## 8 BASHKËPUNIMI ME NJËSITË E BRENDSHME TË INSTITUCIONIT

Për llogari të monitorimit dhe vlerësimit të mbajtjes së licencës së operimit, njësia përgjegjëse për këto licenca, bashkëpunon sipas nevojave, por nuk kufizohet, me:

8.1 Njësinë për mbikëqyrjen ekonomike, e cila është përgjegjëse për monitorimin e qëndrueshmërisë financiare të transportuesit ajror. Në varësi të problematikës së analizës së qëndrueshmërisë financiare, paraqitur nga njësia e mbikëqyrjes ekonomike, Drejtori i Drejtorisë njofton Drejtorin Ekzekutiv mbi situatën ekomomike të operatorit ajror dhe rekomandimet përkatëse të dhëna për të. Në varësi të vendimmarrjes, ndiqen procedurat e përcaktuara nga njësia e licencave të operimit për pezullimin apo anulimin e licencës.
Gjithashtu, në rastet kur nga njësia e licencave të operimit është lëshuar një licencë e përkohshme e operimit, njësia për mbikëqyrjen ekonomike informon njësinë për licencat e operimit për përmbushjen ose jo të kushteve financiare brenda periudhës 12 mujore.
Specifikat e matjes së indikatorëve të kritereve financiarë për mirëmbajtjen apo pezullimin ose anulimin e licencës së operimit bëhen nga njësia e mbikëqyrjes ekonomike, sipas procedurave të brendshme të saj.

8.2 Njësinë e sigurisë ajore, në lidhje me licencën e operimit vlerësuar në raport me përditësimin e regjistrit të avionëve dhe me ndryshimet në Certifikatën e Operatorit Ajror. Në rast të këtyre përditësimeve dhe/apo ndryshimeve, kjo njësi informon njësinë për licencat e e operimit.

## 9 FORMAT

**<u>Format e mwposhtme jhane bashkelidhur esaj procedure dhe miratimit te ksaj</u>**

9.1 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.01: Kërkesa për pajisjen me Licencë Operimi të Transportit Ajror
9.2 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.02: Formati i sygjeruar për planin e biznesit
9.3 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.03: Të ardhurat e parashikuara me bazë mujore për vitin e parë të akvititetit. Buxheti ekonomik tremujor, gjashtëmujor dhe 3 vitet e para te aktivitetit.
9.4 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.04: Performancë ekonomike e parashikuar për 3 vitet e para të aktivitetit

9.5 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.05: Pasqyra e kapitalit të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit për 3 vitet e para (Gjendja e kapitalit)
9.6 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.06: Pasqyra e flukseve të parashikuara të parasë për vitin e parë të aktivitetit, për çdo zë kryesor të arkëtimeve dhe pagesave sipas tipologjisë së shërbimit të arkëtuar/paguar.
9.7 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.07: Parashikimi mbi indikatorët operative.
9.8 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.08: Skeda e monitorimit 6-mujor.
9.9 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.09: Modeli i licencës së operimit.
9.9 Forma O5-1.FPRC.01.FRM.10: Modeli i licencës së përkohshme të operimit.

## 10 REKORDET

10.1 Dokumentacioni i prodhuar arkivohet për vitet e parashikuara për kësi dokumentash në Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

## Forma O5-1.FPRC.01.FRM.01

## APLIKIMI PËR PAJISJEN ME LICENCË OPERIMI TË TRANSPORTIT AJROR

Emërtimi:
Selia ligjore:
Data dhe vendi i themelimit:
Numri i regjistrimit të shoqërisë:
Telefoni:
Fax:
Email:
Faqe web:
Aplikim për Tip A ☐ ose Aplikim për Tip B ☐ të Licensës së Operimit ( Tip A avionë me 20 vende ose më shumë, Tipi B me më pak se 20 vende)
Data e paraqitjes së kërkesës për lëshimin e COA:
Llojet e shërbimeve të transportit ajor që propozohen
Data e parashikuar për fillimin e operimit
Bazat operative:

***STRUKTURA E SHOQËRISË***

Përcaktoni më poshtë detaje mbi çdo person apo shoqëri që zotëron më shumë se 5% të totalit të njësive/aksioneve të emetura(lëshuara).

Emri i Anëtarit(aksionerit):
Nënshtetësia:
Numri i njësive/ aksioneve:
Lloji i njësive/ aksioneve:
% mbi totalin e lëshuar:

***TË DHËNA MBI GRUPIN E MUNDSHËM TË SHOQËRIVE***

Emri i shoqërisë/-ve kontrolluese (nëse ka), data dhe vendi i themelimit:
Emri i shoqërisë mëmë (nëse ka), data dhe vendi i themelimit:

***PËRBËRJA E SHOQËRISË E CILA KONTROLLOHET NGA SHOQËRIA MËMË***

Në qoftë se aplikanti është një shoqëri që kontrollohet nga Shoqëria mëmë të përcaktohen në vijim të dhënat për çdo person apo shoqëri që zotëron më shumë se 5% të totalit të aksioneve të lëshuara nga Shoqëria kontrolluese.

Emri i Anëtarit(aksionerit):
Nënshtetësia:
Numri i njësive/ aksioneve:
Lloji i njësive/ aksioneve:
% mbi totalin e lëshuar:

***ÇËSHTJE TË TJËRA QË MUND TË NDIKOJNË NË KONTROLLIN EFEKTIV TË APLIKUESIT***

| |
|---|
| Informacione të tjera që s'janë dhënë më sipër dhe që lidhen me personin që zotëron pronësinë dhe kontrollin efektiv të shoqërisë. |

***ORGANI ADMINISTRATIV***

Shënoni më poshtë emrat dhe kombësitë e anëtarëve të Bordit Drejtues të shoqërisë së aplikuesit dhe të çdo shoqërie tjetër kontrolluese të deklaruar.

| |
|---|
| Përbërja e Bordit Drejtues të aplikantit:<br>Përbërja e Bordit Drejtues të shoqërisë kontrolluese(mëmë): |

***MENAXHIMI I LARTË***

Shënoni më poshtë detajet mbi funksionet ekzekutive pranë shoqërisë së aplikuesit , kjo nuk i referohet administratorëve të lartpërmendur.

| |
|---|
| Emri(Emërtimi)<br>Nënshtetësia:<br>Detyra(funksioni) |

***MARRËVESHJE FINANCIARE***

Përcakto të dhënat financiare ose jo, të çdo marrëveshjeje, që mund të ketë një lidhje me kontrollin e shoqërisë së aplikantit,tek një fletë e veçantë.

| |
|---|
| Çdo garanci<br>Çdo kredi të ndryshme nga ato të ofruara nga bankat apo institucionet financiare<br>Çdo marrëveshje operative apo tregtare që përfshin një tjetër transportues<br>Të tjera |

***DEKLARIM***

| |
|---|
| Data<br>Emri<br>Pozicioni që mbulon(funksioni)<br>Nënshkruar(firmosur) |

***DOKUMENTACION I BASHKËLIDHUR***

| | |
|---|---|
| *Çertifikatë rregjistrimi QKR* | |
| *Kopje të Aktit të Themelimit* | |
| *Kopje të Statutit dhe ndryshimeve te tij* | |
| | |
| *Ekstrakti ligjor i librit të aksionarëve( ortakëve)* | |
| Certifikate personale, vërtetim banimi dhe vërtetim nga organet kompetente nëpërmjet të cilit verifikohet që personi nuk është i dënuar dhe nuk ka proces penal të hapur ndaj tij ose dokumenta të barazvlefshme me to | |
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.01 *e procedurës* | |

| | |
|---|---|
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.02 *e procedurës* | |
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.03 *e procedurës* | |
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.04 *e procedurës* | |
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.05 *e procedurës* | |
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.06 *e procedurës* | |
| *Forma* O5-1.FPRC.01.FRM.07 *e procedurës* | |

**Forma O5-1.FPRC.01.FRM.02**

# FORMATI I SUGJERUAR PËR PLANIN E BIZNESIT

**a) Përmbledhje ekzekutive**
- Misioni;
- Objektivat;
- Faktorët e suksesit.

**b) Përmbledhja e kompanisë**
- *Pronësia e kompanisë* - duke përfshirë detajet e burimit të financimit dhe aksionarëve të propozuar, kombësinë e tyre dhe detajet e plota të aksioneve të zotëruara. Dokumentacioni i dobishëm mbështetës do të përfshinte çdo marrëveshje të aksionerëve dhe Nenet e Shoqatës;
-*Përmbledhja e fillimit* - përfshin detaje të kostove dhe se si do të financohen këto;

-*Vendndodhja* dhe objektet e zyrës qendrore.

**c) Analiza SWOT**
- Përparësitë;
- Dobësitë;
- Mundësitë;
- Kërcënimet.

**d) Shërbimet**

- Përshkrimi i shërbimeve të propozuara që do të operohen - duke përfshirë linjat dhe oraret e propozuara;

- Strategjia e çmimeve – detajet e strukturës së tarifës;

- Teknologjia e disponueshme - zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të prodhimit ose rezervimit të brendshëm ose blerja e teknologjisë ekzistuese;

- Mënyra dhe arsyet për zgjedhjen e avionit (qiratë ose blerje). Draftet e çdo marrëveshjeje të propozuar;

- Draft-Kontratat me palët e treta - Duhet të sigurohen kopjet e çdo kontratë të propozuar.

(për mirëmbajtjen e avionëve, karburantin, normat e interesit ose marrëveshjet me blerësin tregtar për trajtimin e faturave të kreditit, etj).

**e) Analiza e Tregut**
- Një raport mbi mjedisin aktual të tregut të fluturimeve;
- Detajet e konkurentëve në çdo route të synuar;
- Bazat e supozimeve të kërkesës të përdorura në parashikimet financiare;
- Çdo studim i pavarur i kërkimit të tregut;

**f) Strategjia dhe zbatimi**
- Strategjia e marketingut;
- Strategjia e çmimeve;
- Strategjia e promovimit;
- Strategjia e shitjes;

**g) Përmbledhje e menaxhimit**
- Struktura organizative;
-Ekipi i Menaxhmentit-përfshirë CV-të;
- Plani i personelit.

**h) Vlerësimi i rrezikut të biznesit dhe atij financiar**
-AAC do të duhet të sigurohet që aplikanti ka sisteme të përshtatshme për monitorimin e rreziqeve të tilla dhe politika të mjaftueshme për të zbutur ndikimet e një rreziku të tillë.
Rreziqet kryesore që duhen marrë parasysh duhet të përfshijnë sa vijon;

Rreziku i biznesit;
Risku financiar;
Konkurrenca;
Karburanti;
Humbja e pjesës së tregut;
Këmbimi valuator;
Strategjia e shpërndarjes;
Strategjia e produktit
Rentabiliteti;
Problemet në rajonet e operuara;
Bilanci i gjendjes.

**i) Parashikimet financiare**

Parashikimet financiare duhet të përfshijnë sa vijon;

- Parashikime të detajuara për një periudhë trevjeçare që përfshin llogarinë fitim/humbje, parashikimin e fluksit të parasë dhe bilancet me bazë mujore.
- Parashikimet duhet të detajojnë minimalisht treguesit kryesorë të performancës, si: kapacitetin, load factor, rendimentet (bruto& neto) dhe pasagjerët. Gjithashtu duhet të përfshijë informacionin mbi fluturimet e skeduluara, charterat, si dhe të ardhura ndihmëse.
- Duhet të jepen detaje të plota të parashikimit në lidhje me të ardhurat dhe kostot.
- Kur aplikanti është pjesë e një grupi, AAC do të kërkojë që informacioni i parashikimit të mësipërm të jepet mbi një bazë të konsoliduar, e cila ndan veçmas divizionet e ndryshme tregtare të grupit;
- Nëse aplikanti ka kryer më parë aktivitet tregtar, duhet të dorezojë llogaritë e audituara më së fundi. Nëse aplikanti është pjesë e një grupi, atëherë duhet të dorëzojë llogaritë e audituara për kompaninë mëmë.

## Forma O5-1.FPRC.01.FRM.03

### TË ARDHURAT E PARASHIKUARA ME BAZË MUJORE PËR VITIN E I-RË TË AKIVITETIT

| Parashikimi | Jan | Feb | Mar | Apri | May | Jun | Jul | Aug | Sep | Oct | Nov | Dec | Total/average |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kapaciteti i sediljeve në shitje** | | | | | | | | | | | | | |
| **Load Factor** | | | | | | | | | | | | | |
| **Pasagjerë** | | | | | | | | | | | | | |
| **Të ardhura totale** | | | | | | | | | | | | | |

### BUXHETI EKONOMIK 3- MUJOR, 6-MUJOR DHE VITI I-RË I AKTIVITETIT

3 muaj 6 muaj 31.12 (viti 1)

Të ardhura nga fluturimet e skeduluara
Të ardhura nga fluturimet charter
Të ardhura të tjera ndihmëse
**Të ardhurat nga aktiviteti**
Shpenzime karburanti për avion
Shpenzime tarifa aeroportuale për pasagjerët
Shpenzime ground –handling
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe revizionimi (kontrolli)
Qiramarrja dhe qiradhënia
Shpenzime tregtare dhe marketingu
Shpenzime të sigurimit
**Kosto e shitjes**
**Fitimi Bruto**
Shpenzime për personelin
Shpenzime administrative
Amortizimi i pronës dhe pajisjeve
**Fitimi operacional (*EBITDA*)**
Interesa mbi furnitorët financiarë

Të ardhura të tjera/shpenzime
Fitimi/humbje nga shitja e aseteve jo korente
Të tjera shpenzime financiare
**Fitimi (humbja) para taksave (EBITA)**
Shpenzimeve tatim fitimi aktual
**Fitimi (humbja) Neto**
*: Për vitin e parë të aktivitetit, 3 muaj dhe 6 muaj llogariten që nga data e parashikuar e fillimit të aktivitetit.

# Forma O5-1.FPRC.01.FRM.04

## PERFORMANCË EKONOMIKE E PARASHIKUAR PËR 3 VITET E PARA TË AKTIVITETIT

| | 31.12.n | 31.12.n+1 | 31.12.n+2 |
|---|---|---|---|
| Të ardhurat e trafikut | | | |
| Të ardhura të tjera | | | |
| **Të e ardhurat nga aktiviteti** | | | |
| Shpenzime karburanti per avion | | | |
| Shpenzime tarifa aeroportuale për pasagjerët | | | |
| Shpenzime ground –handling | | | |
| Shpenzime mirëmbajtjeje dhe revizionimi (kontrolli) | | | |
| Qiramarrja dhe qiradhënia | | | |
| Shpenzime tregtare dhe marketingu | | | |
| Shpenzime të sigurimit | | | |
| **Kosto e shitjes** | | | |
| **Fitimi Bruto** | | | |
| Shpenzime për personelin | | | |
| Shpenzime administrative | | | |
| Amortizimi i pronës dhe pajisjeve | | | |
| Amortizimi i aseteve të paprekshme | | | |
| **Fitimi operacional (*EBITDA)*** | | | |
| Interesa mbi furnitorët financiare | | | |
| Të ardhura te tjera/shpenzime | | | |
| Fitimi/humbje nga shitja e asteve jo korente | | | |
| Të tjera shpenzime financiare | | | |
| **Fitimi (humbja) para taksave (EBITA)** | | | |
| Shpenzimeve tatim fitimi aktual | | | |
| **Fitimi (humbja) Neto** | | | |

# Forma O5-1.FPRC.01.FRM.05

## PASQYRA E KAPITALIT E PARASHIKUAR E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT PËR 3 VITET E PARA (GJENDJA E KAPITALIT)

| | 31.12.n | 31.12.n+1 | 31.12.n+2 |
|---|---|---|---|
| **Gjendja në fillim të periudhës** | | | |
| Kapital i nënshkruar i paguar | | | |
| Kapital i nënshkruar i papaguar | | | |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | | | |
| **Balanca në fund të periudhës** | | | |
| Kapital i nënshkruar i paguar | | | |
| Kapital i nënshkruar i papaguar | | | |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | | | |
| **Balanca në fund të periudhës 31.12n+1** | | | |
| Kapital i nënshkruar i paguar | | | |
| Kapital i nënshkruar i papaguar | | | |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | | | |
| **Balanca në fund të periudhës 31.12.n+2** | | | |

## TË PËRDORURA

| | 31.12.n | 31.12.n+1 | 31.12.n+2 |
|---|---|---|---|
| Kredi ndaj aksionerëve për derdhje C.S. | | | |
| Kapital i ngurtësuar | | | |
| Pasuri jomateriale | | | |
| Materiale | | | |
| Financiare | | | |
| **AKTIV I NGURTËSUAR** | | | |
| Teprica (pjesa e mbetur) | | | |
| Kredi | | | |
| Aktivitete financiare | | | |

Disponibiliteti likuid
Këste dhe diskonte aktive
**AKTIV QARKULLUES**
**KAPITALI I INVESTUAR**

| BURIME | **31.12.n** | **31.12.n+1** | **31.12.n+2** |
|---|---|---|---|
| Kapitali i Shoqërisë | | | |
| Fondet rezervë | | | |
| Fitimet nga ushtrimi i aktivitetit | | | |
| **GJENDJA E KAPITALIT NETO (CP)** | | | |
| Fonde në rast rreziku dhe për detyrimet (taksat) | | | |
| TFR | | | |
| Borxhe financiare afatmesëm dhe afatgjatë | | | |
| **DETYRIME TË KONSOLIDUARA (PC)** | | | |
| Borxhe tregtare | | | |
| Borxhe financiare afatshkurtër | | | |
| Diskonte pasive | | | |
| **DEFICIT RRJEDHËS (PB)** | | | |
| **BURIME TË SHFRYTËZUARA (FI)** | | | |

## Forma O5-1.FPRC.01.FRM.06

### PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASHIKUARA TË PARASE PËR VITIN E I-RË TË AKTIVITETIT , PËR ÇDO ZË KRYESOR TË ARKËTIMEVE DHE PAGESAVE SIPAS TIPOLOGJISË SË SHËRBIMIT TË ARKËTUAR/PAGUAR

| Parashikimi | Jan | Shk | Mar | Pril | Maj | Qer | Kor | Gus | Shta | Tet | Nen | Dhj | Shuma/mes |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja në fillim** | | | | | | | | | | | | | |
| **Shpenzime**<br>-Shitje direkte<br>-Shitje charter<br>-Të tjera të ardhura (specifikoni) | | | | | | | | | | | | | |
| **Të ardhura**<br>-Karburant<br>-Të tjera<br>-Eurocontrol<br>-Taksat e uljeje<br>-Shërbimet në tokë<br>-Taksa të pasagjerëve<br>-Catering<br>-Kosto fikse të mirëmbajtjes<br>-Kosto variabël të mirëmbajtjes<br>-Personeli<br>-Qiradhënia e makinave<br>-Sigurimi i makinave<br>-Qera<br>-Marketing<br>-Taksa<br>-Të tjera (specifikoni | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Balanca e mbyllur** | | | | | | | | | | | | | |

# Forma O5-1.FPRC.01.FRM.07

## PARASHIKIM MBI INDIKATORËT OPERATIVE

| Të dhena mbi trafikun dhe punonjësit | Viti I | Viti II | Viti III |
|---|---|---|---|
| Fluturimet | | | |
| Pasagjerët | | | |
| Load Factor pasagjerë | | | |
| Numri i punonjësve në 31.12 | | | |
| Numri mesatar i punonjësve | | | |

| Tipologjia AA/MM | Tipi A | Tipi B |
|---|---|---|
| -Numri i avionëve<br>-BH e përdorshme<br>-Konfigurimi mesatar AA/MM<br>-Ekuipazhi x AA / MM<br>-Konsumi i karburantit x BH<br>-Kosto karburanti x BH<br>-Shpenzimet e tjera (specifiko) | | |
| Kostoja totale për BH | | |

# Forma O5-1.FPRC.01.FRM.08

## SKEDA E MONITORIMIT GJASHTËMUJOR

| Shoqëria | |
|---|---|

| Periudha e shqyrtuar[1] | |
|---|---|
| | |
| **Fluturimet operative** | |
| Destinacionet (A/R) Lloji Pax të transportuara Load factor | |
| **Marrëveshje tregtare me operatorë të tjerë** | |
| Transportues "operator" Transportues MKTG Destinacionet e interesuara Lloji i marrëveshjes | |
| **Përbërja e flotës** | |
| Tipologjia e makinave Titujt e disponueshëm | |
| **Të dhëna operative** | |
| Orët e fluturimit me destinacion të largët<br>Orët e fluturimit me destinacion të mesëm<br>Personeli drejtues(ekuipazhi)<br>Personeli i kabinës | |
| **Të dhëna ekonomike** | |
| Xhiroja<br>Kosto karburanti<br>Kosto personeli<br>Kosto dry lease<br>Kosto ëet lease<br>Kosto mirëmbajtjeje<br>Kosto totale<br>Rezultati i periudhës<br>Situata e borxhit total<br>Borxhe kundrejt handler-ave<br>Borxhe kundrejt aksionerëve të administrimit | |

| | | |
|---|---|---|
| Borxhe kundrejt Eurocontrol | | |
| Totali i gjendjes kreditore | | |
| **Vonesa e anullime** | | |
| Totali rrugëve | nr. i vonesave | nr. i anullimeve |

[1] Si periudhë e shqyrtuar do të konsiderohet gjashtëmujori kalendarik.

Në rast se veprimtaria nis në një semestër që ka filluar, të dhënat do të lidhen me atë pjesë kohe gjatë së cilës është kryer vetë aktiviteti.

**Forma e licencës së operimit O5-1.FPRC.01.FRM.09**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
REPUBLIC OF ALBANIA

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**
CIVIL AVIATION AUTHORITY

**LICENCË OPERIMI**
*OPERATING LICENSE*
Nr./ No. **AL - 001**

**"TRANSPORTUESI AJROR" SHPK**

**Me Zyrë Qendrore**/*Legal Address*: Adresa e plotw sipas regjistrit tregtar të transportuesit ajror

**përmbush kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në Udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve Nr. 17, datë 02.09.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", i ndryshuar dhe autorizohet për të kryer transport nga ajri të pasagjerëve, kargos dhe/ose postës, për qëllime fitimi ose qiraje, sipas specifikimeve bashkëlidhur.**

*fulfills the requirements stipulated in Law No. 96/2020 "Air Code of Republic of Albania" and Minister Ordinance No. 17, date 02.09.2010 "On the applicable rules of operation in the field of air services", as amended and is hereby authorized to carry by air passengers, cargo and/or mail for hire and or remuneration according to the attached specification.*

**Kjo Licencë nuk është e transferueshme dhe do të jetë në fuqi deri sa të pezullohet ose revokohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.**

*This License is not transferable and shall remain in force unless suspended or revoked by the Civil Aviation Authority.*

**Lëshimi** *Nr. / Issue No.:*
**Datë**/ *Date:* dita/muaji/viti

**Emri dhe Firma**

*Name and Signature*

______________________

**DREJTOR EKZEKUTIV**
*EXECUTIVE DIRECTOR*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
REPUBLIC OF ALBANIA
**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**
CIVIL AVIATION AUTHORITY

**SPECIFIKIMET E LICENCËS SË OPERIMIT**
*OPERATING LICENSE SPECIFICATIONS*

**Licenca e Operimit Nr.** AL- 001

*Operating License No* AL- 001

**Operatori**/ *Operator:* **"Transportuesi ajror" SHPK**

**Lloji i Licencës**/ *Type of License*: MTOW ≥ 10 ton

**Pasagjerë**- passengers ≥ 20

**Lloji i Operimeve**/ *Type of Operations:* Transport:

- **pasagjerësh**/*Passengers*
- **kargo**/*Cargo*
- **postë**/*Mail*

**Administratori**/ *Accountable Manager*: **Emri i administratorit sipas regjistrit tregtar të subjektit**

**Pezullime**/ *Suspensions*:

**Lëshimi Nr.** / *Issue No.*
**Datë**/ Date: dita/muaji/viti

Emri dhe Firma
*Name and signature*

______________________

**DREJTOR EKZEKUTIV**
*EXECUTIVE DIRECTOR*

## Forma e licencës së përkohshme të operimit O5-1.FPRC.01.FRM.10

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
REPUBLIC OF ALBANIA
**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**
CIVIL AVIATION AUTHORITY

**LICENCË OPERIMI E PËRKOHSHME**
*TEMPORARY OPERATING LICENSE*
Nr./ No. **AL - 001**

**"TRANSPORTUESI AJROR"** SHPK

**Me Zyrë Qendrore**/*Legal Address*: Adresa e plotë sipas regjistrit tregtar të transportuesit ajror

**Bazuar nw kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në Udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve Nr. 17, datë 02.09.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", i ndryshuar dhe autorizohet për të kryer transport nga ajri të pasagjerëve, kargos dhe/ose postës, për qëllime fitimi ose qiraje, sipas specifikimeve bashkëlidhur, për një periudhë deri në 12 muaj.**

*Based on the requirements stipulated in Law No. 96/2020 "Air Code of Republic of Albania" and Minister Ordinance No. 17, date 02.09.2010 "On the applicable rules of operation in the field of air services", as amended and is hereby authorized to carry by air passengers, cargo and/or mail for hire and remuneration according to the attached specification, for a period up to 12 months.*

**Kjo Licencë nuk është e transferueshme dhe do të jetë në fuqi deri sa të pezullohet ose revokohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.**

*This License is not transferable and shall remain in force unless suspended or revoked by the Civil Aviation Authority.*

**Lëshimi** *Nr. / Issue No.:*
**Datë**/ *Date:* dita/muaji/viti

**Emri dhe Firma**
*Name and Signature*

______________________

**DREJTOR EKZEKUTIV**
*EXECUTIVE DIRECTOR*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
REPUBLIC OF ALBANIA
**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**
CIVIL AVIATION AUTHORITY

**SPECIFIKIMET E LICENCËS SË PËRKOHSHME TË OPERIMIT**
*TEMPORARY OPERATING LICENSE SPECIFICATIONS*

**Licenca e Përkohshme e Operimit Nr.** AL- 001

*Temporary Operating License No* AL- 001

**Operatori**/ *Operator:* **"Transportuesi ajror" SHPK**

**Lloji i Licencës**/ *Type of License*: MTOW ≥ 10 ton

**Pasagjerë**- passengers ≥ 20

**Lloji i Operimeve**/ *Type of Operations:* Transport:

- **pasagjerësh**/*Passengers*
- **kargo**/*Cargo*
- **postë**/*Mail*

**Administratori**/ *Accountable Manager*: **Emri i administratorit sipas regjistrit tregtar të subjektit**

**Pezullime**/ *Suspensions*:

**Afati**/ Deadline **Deri në 1 vit**/ Up to 1 year

**Lëshimi Nr.**/ *Issue No.*
**Datë**/ Date: dita/muaji/viti

Emri dhe Firma
*Name and signature*

______________________

**DREJTOR EKZEKUTIV**
*EXECUTIVE DIRECTOR*